ALTAX OBSERVATORY | ANALIZË BUXHETORE

# BUXHETI 2027

## Qëndrueshmëria fiskale dhe kufijtë e transformimit ekonomik

ALTAX

Analizë e përballueshmërisë fiskale, hapësirës buxhetore dhe kapacitetit për zhvillim

**2.3%**

**Deficiti / PBB**

**52.4%**

**Borxhi bruto / PBB**

**2.8 / 5**

**Impact Score mesatar**

Nëntor 2026

ALTAX INSIGHT Evidence. Context. Implications.

ALTAX OBSERVATORY

# Mesazhi qendror: stabilitet pa transformim të provuar

## Buxheti 2027 është fiskalisht i përballueshëm, por në aspektin zhvillimor i kufizuar.

- Parametrat kryesorë fiskalë ruhen: deficit 2.3% e PBB-së dhe borxh bruto 52.4%.
- Hapësira e manovrimit mbetet e ngushtë: rezerva buxhetore është 12.7 mld lekë.
- Struktura e kapitalit publik nuk tregon ende një orientim të mjaftueshëm drejt kapitalit njerëzor dhe prodhimit.

**Përputhshmëria fiskale është kusht i domosdoshëm, por jo provë e kapacitetit zhvillimor.**

# Kuadri fiskal: parametrat kryesorë të vitit 2027

**907.9 mld**

**Të ardhura**

30.9% e PBB-së

**976.1 mld**

**Shpenzime**

33.3% e PBB-së

**68.2 mld**

**Deficit**

2.3% e PBB-së

**52.4%**

**Borxh bruto**

E PBB-së

## Balanca primare: 0.0% e PBB-së

Interesat prej 68.3 mld lekësh janë pothuajse sa vetë deficiti. Kjo do të thotë se e gjithë hapësira e krijuar para interesave konsumohet nga kostoja e shërbimit të borxhit.

# Të ardhurat: rritje mbi ekonominë, por me bazë të brishtë

## Rritja e të ardhurave

**+7.7%**

**Të ardhura totale**

PBB nominale: +5.2%

**+11.1%**

**TVSH**

**+11.5%**

**Tatimi mbi të ardhurat personale**


**–5.1%**

**Tatimi mbi fitimin, 8M 2026**

## 48% e rritjes së tatimeve mbështetet te administrimi dhe korrektimet

Rreth 22.8 mld lekë kërkojnë ndarje më të qartë mes efektit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, masave të administrimit dhe korrektimeve. Pa këtë ndarje, parashikueshmëria e të ardhurave mbetet e dobët.


# Shpenzimet: shtrëngim në funksionet bazë, rritje në fondet speciale




**Përballë inflacionit 3.0%, rritjet e pagave, shpenzimeve operative dhe buxhetit vendor nënkuptojnë tkurrje reale ose presion mbi cilësinë e shërbimeve.**

# Investimet publike: shpërndarja e kapitalit

## Kapitali publik 2027: 200.3 mld lekë




**Arsimi dhe shëndetësia së bashku marrin 5.8% të kapitalit, kundrejt 21.8% për Mbrojtjen.**

# Impact Score: cilësia zhvillimore e portofolit

**2.8 / 5**

**Impact Score mesatar**

2.7 kur peshohet me vlerën e investimeve

**1.6 / 5**

**Mbrojtja**

Vlerësim i ndikimit zhvillimor

**3.6 / 5**

**Arsimi dhe shëndetësia**

Vlerësim relativisht më i lartë

## Çfarë tregon rezultati?

- Portofoli ka performancë mesatare dhe jo transformuese.
- Pesha e lartë e disa zërave nuk përkthehet automatikisht në ndikim ekonomik e social.
- Projektet duhet të lidhen me rezultate të matshme, jo vetëm me vlerën e financimit.

# Rreziku operacional: kapaciteti i zbatimit

**32.3%**

**Realizimi i kapitalit në 8M 2026**

Si pjesë e planit vjetor

**+13.7%**

**Rritja e planit kapital 2027**

Mbi një ritëm zbatimi të paprovuar

**14.1 mld**

**Plani i Rritjes 2027**

Nga 1.8 mld në 2026

**Rreziku kryesor nuk është vetëm sigurimi i financimit, por aftësia për ta kthyer atë në projekte të përfunduara dhe shërbime publike.**

Nevojitet raportim tremujor sipas projektit: fondi i planifikuar, fondi i disbursuar, progresi fizik, vonesat dhe rezultati i arritur.

# Angazhimet shumëvjeçare: presion mbi buxhetet e ardhshme

**1,592.6 mld**

**Vlera e listave të projekteve**

Portofoli 2027–2029

**612.7 mld**

**Pagesa pas vitit 2029**

38.5% e vlerës së projekteve

**54%**

**Infrastruktura pas 2029**


Peshë e lartë e angazhimeve të shtyra

**Respektimi i kufirit ligjor të PPP-ve nuk e zëvendëson analizën e detyrimeve shumëvjeçare.**

Çdo projekt i madh duhet të shoqërohet me koston totale të ciklit të jetës, normën e pritshme të kthimit ekonomik dhe ndikimin mbi hapësirën fiskale të viteve pas 2029.

# Politika sociale: bonusi universal dhe dobësimi i synimit

## Rritja e bonusit të pensionistëve (mld lekë)




**40 mld lekë në 2029**

**Rreth 1.5 herë ndihma ekonomike dhe aftësia e kufizuar së bashku.**

Rekomandim: bonus me rregulla të qarta orientimi, që kombinojnë mbështetjen universale me nevojën dhe të ardhurat reale të familjeve.

# Pesë ndërhyrje për një buxhet më zhvillimor

| | | |
|---|---|---|
| 01 | **Rritja e kapitalit njerëzor dhe prodhimit** | Orientimi i kapitalit nga 11.4% drejt 15%. |
| 02 | **Stabilizimi i shpenzimeve të Mbrojtjes** | Vlerësim në terma realë, duke respektuar angazhimet ndaj NATO-s. |
| 03 | **Rregulla për bonusin e pensionistëve** | Kriter transparence, qëndrueshmërie dhe orientimi social. |
| 04 | **Disiplinë për projektet mbi 1 mld lekë** | Normë kthimi, analizë kosto-përfitim dhe tregues rezultati. |
| 05 | **Transparencë mbi burimet dhe zbatimin** | Ndarje SAA/korrektime dhe raportim tremujor i ekzekutimit. |

# Stabiliteti fiskal nuk është i njëjtë me transformimin ekonomik.

Buxheti 2027 ruan kufijtë e financimit publik, por struktura e shpenzimeve, siguria e të ardhurave dhe kapaciteti i zbatimit kufizojnë fuqinë e tij për të ndryshuar modelin ekonomik.

**Testi real i buxhetit nuk është vetëm nëse financohet, por çfarë ndryshon në ekonomi, në produktivitet dhe në mirëqenien e qytetarëve.**